



**Datë:** 16.06.2025

**Numër Protokolli:** 4121/2025

**A.nr.818/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.818/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesja I.B të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Enis Dema nga Kaçaniku, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pa bazuar** ankesa A.nr.818/2025, e datë 05.05.2025, e parashtruar nga ankuesja I.B.

**II. Mbetet** në fuqi Vendimi me numër referencës DS-174/2025, i datës 26.03.2025, i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

## A r s y e t i m

Ankuesja I.B (*tutje referuar ankuesi*), më datë 28.04.2025 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 05.05.2025, kundër Vendimit me numër referencës DS-174/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak: të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit jo të drejtë të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.05.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (*tutje referuar SKGJK*), ndërsa Këshilli më datë 23.05.2025 ka pranuar përgjigje, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 2959/2025 të datës 05.05.2024, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër referencës DS-174/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së; Dëshminë për pranim të aktit e datës 01.04.2025; Vendimin KGJK.nr.01/2023 të datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Kërkesën për pagës të diferencës së pagës e datës 11.03.2025 nga ankuesi për Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Akt Emërimit Nr.03/1159 t datës 01.07.2024; Listën e pagave shkurt 2023, dhe korrik e shtator 2024; Kopjen e ID-së së ankuesit; Autorizimin e datës 12.02.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 23.05.2025; Listat e pagave dhjetor, nëntor, tetor, shtator, gusht, korrik, maj, prill, mars, shkurt, janar të vitit 2024, Akt Emërimit e datës 2012.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi fillimisht sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012 ka themeluar marrëdhënie pune në pozitë *Sekretar Juridik* në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik në kuadër të SKGJK-së, dhe para hyrjes në fuqi të ligjit të ri të pagave ka qenë duke realizuar koeficient të pagës gjashtë (6), ndërsa pas miratimit të Rregullores Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civile në Administratën e Sistemit Gjyqësor i është lëshuar akt emërimi me numër Reference DS-674/2024 i datës 01.07.2024 për pozitën e njëjtë, kategoria profesional 2, me koeficient të pagës 5.30.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi përmes përfaqësuesit të tij, më datë 11.03.2025, i është drejtuar me kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar diferencën e pagës prej muajit shkurt 2023 deri në qershor 2024, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, më datë 26.03.2025, ka nxjerr Vendim me numër reference DS-172/2025, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankueses.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me referencës DS-174/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së të cilin sipas dëshmisë e ka pranuar më datë 01.04.2025, pretendon se akti i kundërshtuar me ankesë është nxjerr si rezultat i vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike she aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale, ngase Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datës 18.01.2023 ka nxjerr vendim për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor ku pozita e Sekretarit Juridik është klasifikuar në klasën profesional 2, grupi J, klasa J16, koeficienti 5.30, ndërsa ky vendim nuk është zbatuar edhe përkundër faktit që nuk ka pasur ndonjë akt që e pezullon zbatimin e këtij vendimi dhe ky vendim nuk është zbatuar deri në qershor të vitit 2024, ashtu që kërkon që të aprovohet ankesa dhe të anulohet akti i kundërshtuar me ankesë dhe të bëhet kompensimi i diferencës së pagës nga klasa profesional 3 me koeficienti 4.3 në klasën profesional 2 në koeficientin 5.30 nga muaji shkurt 2023 deri në muajin qershor 2024.

Kolegji i Këshillit, konstaton se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (i zbatueshëm nga data 05.02.2023), ndërsa me qëllim të implementimit të këtij ligji, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datës 18.01.2023 ka nxjerr Vendimin KGJK. nr.01/2023, për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në gjyqësor, ku sipas këtij vendimi janë përcaktuar grupi, klasa dhe koeficientit për çdo pozitë, e për rrjedhojë sipas pikës 16 të këtij vendimi janë përcaktuar pozitat e klasës profesional 1 grupi J, Klasa J15 dhe koeficientit 5.85 e ndër pozitat e përfshira ka qenë edhe pozita Sekretare Juridike që mban ankuesja gjegjësisht sipas pikës 16.13 të këtij vendimi.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, ju referuar Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, 2 dhe 3, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj. 3. Për nëpunësit/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil të Sistemit Gjyqësor përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.2 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e brendshme të aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Sistemin Gjyqësor.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Këshilli Gjyqësor i Kosovës, sipas Vendimin KGJK. nr.01/2023 të datës 18.01.2023, ka përfunduar klasifikimin e vendeve të punës në sistemin gjyqësor, mirëpo procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik dhe rregullat e brendshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë, e në këtë rast ankuesi prej datës 28.12.2012 ka qenë duke u paguar me koeficientin gjashtë (6) dhe në bazë të ekuivalentimit të sistemit të vjetër të pagave me sistemin e ri, pozita e ankuesit nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është ekuivalentuar në klasën profesional 3, me koeficient 4.3, për rrjedhojë duke marr parasysh Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës Kosovës, ka qenë e pamundur të bëhet zbatimi i Vendimit KGJK. nr.01/2023 të datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ngase sipas vendimit të cekur më lartë të Qeverisë së Republikës së Kosovës ky vendim është zbatuar për të gjitha institucionet për të cilat aplikohet Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Duke marr parasysh faktin se institucionet e Sistemit të Drejtësisë, kanë të drejtë që të nxjerrin aktet e brendshme të tyre për të punësuarit në këtë sistem, atëherë Këshilli Gjyqësor i Kosovës më datë 06.06.2024, ka miratuar Rregulloren Nr. 02/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, e për rrjedhojë Kolegji, konstaton se sipas nenit 27 të kësaj rregulloreje është përcaktuar përshkrimi i përgjithshëm i punës, klasat dhe emërtesat për kategorinë profesional 2, e ku ndër pozitave është përfshirë edhe pozita e ankueses Sekretare Juridike, ndërlidhur me tabelën e koeficienteve sipas Grupit J, Klasat J16, Koeficienti 5.30, dhe mbi bazë të kësaj rregulloreje të njëjtit i është lëshuar edhe Akt Emërimi me numër Reference DS-675/2024 të datës 01.07.2024, dhe nga kjo datë e lëshimit të aktit të emërimit, ka filluar së zbatuari edhe kompensimi sipas koeficientit të pagës 5.30.

Andaj lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për kompensim të diferencës së koeficientit të pagës nga klasa profesional 3 me koeficientin 4.3, në klasën profesional 2 në koeficientin 5.30 nga muaji shkurt 2023 deri në muajin qershor 2024, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet e tilla nuk kanë mbështetje ligjore, për faktin se siç e elaboruam edhe më lartë, procedimi i pagës sipas sistemit të ri të pagave të përcaktuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është bërë si rezultat i zbatimit të

Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës e jo si rezultat i Vendimit KGJK. nr.01/2023 të datës 18.01.2023 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për klasifikimin e vendeve të punës ngase i njëjti nuk ka mundur të zbatohet për shkak të rrethanave juridike të krijuara sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat ne Sektorin Publik dhe Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për rrjedhojë edhe kompensimin për periudhën e pretenduar nga ankuesi nuk mund të realizohet, kështu që lidhur me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimit me referencë DS-174/2025, të datës 26.03.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të SKGJK-së, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr si rezultat i konstatimit të drejtë të gjendjes faktike dhe juridike, duke vepruar në plotni me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht pretendimi i ankueses ndaj këtij vendimi është i pabazuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqësor për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda, A.nr.818/2025, datë 16/06/2025.**

**Flakron GASHI**

Procesmbajtës

**Arben MEHMETI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankueses, Avokat Enis Dema,
- Sekretariat të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Drejtorit të Përgjithshëm, dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.